

KQZ
U PROTOKOLLUA
NR/066 PROT
DATE 13.7.2018

RAPORT AUDITIMI

PARTIA DEMOKRISTIANE E SHQIPERISE

**PASQYRAT FINANCIARE TE VITIT
2017**

KORRIK 2018

"PARTIA DEMOKRISTIANE E SHQIPERISE"
TIRANE

AUDITIMI PASQYRAVE FINANCIARE
Per Perludhen 1 Janar- 31 Dhjetor 2017

Tirane 10 Korrik 2018

RAPORTI I AUDITUESIT

Partia Demokratike e Shqipërisë

Adresa: Tirane, Rruga "Abdi Toptani" Tirane

Ne kemi audituar Pasqyrat financiare bashkelidhur te "Partise Kristian Demokrate" Tirane, te cilat perfshijne bilancin kontabel per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2017, pasqyrat perkatese te te ardhurave dhe shpenzimeve, per kete ushtrim, si dhe nje permbledhje te metodave kontabel te rendesishme dhe shenime te tjera ne lidhje me to (anekse).

Pergatitja dhe paraqitja e sinqerte e ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit eshte pergjegjesi e Drejtitmit te Partise. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, venien ne zbatim dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare qe jane pa anomal material, qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit; per te zgjedhur dhe zbatuar metodat e pershtatshme kontabel; si dhe per te bere çmuarjet kontabel qe jane te arsyeshme per rrethanat e dhena.

Pergjegjesia jone eshte qe, bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Ne kemi kryer auditimin ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te zbatojme kerkesat etike dhe te planifikojme dhe kryejme auditimin tone per te mare sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomal material.

Auditimi perfshin ekzaminimin, mbi bazen e testeve, te evidences qe mbashtet shumat dhe informacionet e dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit, duke perfshire vleresimin e rrezqeve per anomal material ne pasqyrat financiare, qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit. Ne berjen e ketyre vleresimeve te rrezikut, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem perkates te shoqerise ne pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare ne menyre qe te hartoje procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat, por jo per qellimin e shprehjes se opinionit per efektiviten e kontrollit te brendshem te shoqerise. Auditimi perfshin gjithashtu, vleresimin e parimeve kontabel te perdorura dhe te llogjiken e çmuarjeve te rendesishme te bera nga Drejtimit, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjitheshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene bazat e opinionit tone te auditimit.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të arketim pagesave dhe jo në bazë të të drejtave të konstatuara.

Sipas opinionit të tone në përfundim të procedurave audit, konkludojmë se pasqyrat financiare të përgatitura, paraqesin besueshmëri të arsyeshme, japin një pamje të vertetë dhe të sinqerte për gjendjet financiare të subjektit politik "Partia Demokratike e Shqipërisë" të gjendjes me 31 Dhjetor 2017, të rezultatit financiar dhe flukseve të parave për ushtrimin e mbyllur, në përputhje me Ligjin nr.8580, dt.17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar dhe Ligjin 9228 date 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Çështje të tjera

Pasqyrat Financiare të Partisë Demokratike të Shqipërisë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 janë audituar dhe ka opinion të shprehur për ato.

Shoqëria audituese "Jaupaj-G" shpk

Gezim JAUPAJ (EKR)

Tirane, Korrik 2018



**SHENIME PLOTESUESE NE LIDHJE ME AUDITIMIN E SUBJEKTTIT POLITIK
"PARTIA DEMOKRISTIANE E SHQIPERISE"
PERIUDHA JANAR-DHJETOR 2017**

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Baza ligjore kryerjen e këtij misioni është marrë në referim të ligjeve:

- Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar.
- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabillit të Miratuar", Standartet Ndërkombetare të auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabillitetin dhe Pasqyrat Financiare,,"
- Cdo dokument ligjor të terhequr prane subjektit politik "Partia Demokratiane e Shqiperise" Tirane.
- Vendimi Nr 23 date 27.04.2018 i Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI PARTINE

1. Të përgjithshme

Partia Demokratiane e Shqipërisë (PDK) është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 11.12.1991 me vendimin numër 40/3.

Kryetari i saj është Z. Nard Ndoka. Partia njihet për qëllime fiskale me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit NUIS K72006001N.


Organizimi dhe drejtimi

Instancat dhe organet qendrore të PDK janë:

- ↓ Kuvendi i Partisë
- ↓ Këshilli Kombëtar
- ↓ Kryetari dhe zëvendësit e tij
- ↓ Kryesia
- ↓ Sekretari i përgjithshëm

Burimet e financimit të PDK-së janë:

- ↓ Të ardhurat nga buxheti i shtetit në përputhje me legjislacionin për financimin e partive politike
- ↓ Ndihmat dhe dhuratat e anëtarëve dhe të përkrahësve të PDK
- ↓ Çdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike.



PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABEL

Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare.

- Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar (NKRF), të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin nr.9228 dt. 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare," dhe Planin Unik Kontabel, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhen vendase në Leke.
- Rregullat për vlerësimin e kërkesave për arkëtim dhe të detyrimeve. Kërkesat për arkëtim janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale të lëshuara nga klientet apo të dokumentave të tjerë kontabël. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave dhe dokumentave origjinale kontabël.
- Rregullat e vlerësimit të likuiditeteve. Gjendjet e likuiditeteve përfshijnë gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhese në bankë në leke. U kontrolluan veprimet e kryera në arkë dhe bankë dhe u konstatuan se regjistrimet në librat e llogarive dhe në ditaret përkatës ishin kryer sipas normave kontabël.
- Të Ardhurat Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre nga donorët dhe përdorimi i tyre është sipas planit të buxhetit të financuar nga projekti.

ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare". Partia ka ndertuar nje plan të llogarive vetjake në përputhje të plote me Planin Unik Kontabël. Kontrolli i brendshem kryhet nga dega e finances. Kontabiliteti mbahet në menyre manuale.

1. Aktivet Afatshkurter

Aktivët monetarë të Partisë përbëhen nga mjetet në banke e në arke. Vlerat e mjetëve në banke përputhen me gjendjen e bankes me 31.12.2017 dhe janë si më poshte:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Totali		
Banke	1,506,589	702,818
Arka	837,539	239,000
Totali		
Banke+Arka	2,344,128	941,818

me poshte:

31
Dhjetor

31
Dhjetor

Shoqëri auditimi "Jaupaj-G" shpk

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Artikuj Iventari ne magazine	0	0
Totali	0	0

2. Aktivët Afatgjatë Materiale

Aktivët afatgjatë në vlerë neto paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Ndërtimë e rikonstruksione	0	0
Mjete transp dhe iventar ekonomik	0	0
Te tjera	0	0
Totali	0	0

3. Detyrime Afatshkurtra

Detyrime afatshkurtra detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Te pagueshme ndaj punonjesve	0	0
Sigurime shoqërore&Tap	0	0
Detyrime te tjera	0	0
Totali	0	0

3.1 Detyrime Afatgjatë

Detyrime afatgjatë detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Detyrime afatgjatë	0	0
Totali	0	0

4. Fondet e veta

Fondet e veta detajohen si me poshte:

	31 Dhjetor 2017	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Fondet Baze	0	0
Teprica e fondeve vitet e kaluara	2,344,128	941,818
Teprica(mungesa) e fondeve te vitit		<u>0</u>
Totall	<u>2,344,128</u>	<u>941,818</u>

5. Pasqyra e të ardhurave .

Subjekti politik "Partia Demokratiane e Shqiperise" ka realizuar te ardhura si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Gjendje fonde me 01.01.2017	941,818
Fonde KQZ (Buxheti Shtetit)	4,833,333
Donacion	0
Te ardhura Kuota e anetareve	0
Te ardhua te tjera	<u>0</u>
Totall	<u>5,775,151</u>

6. Shpenzimet gjithsej.

Shpenzimet financiare detajohen si me poshte:

31 Dhjetor 2017

- Shpenzime për printime, flete volante86 400 leke
- Pritje percjellje50,000 leke
- Ekspertize.....36,000 leke



Shqerri auditimi "Jaupaj-G" shpk

- Udhetim e dieta	85,000 leke
- Paga dhe shtesa	2,295,000 leke
- Taksa vendore	30,399 leke
- Komisione bankare.....	7,162 leke
- Karburant, lubrifikant.....	343,621 leke
- Te tjera (telefoni, energji, uje)	360,539 leke
- Shpenzime te tjera	136,902 leke

TOTALI SHPENZIME **3,431,023 leke**

Lidhur me shpenzimet e mesiperme , u krye verifikimi dhe kontrolli i plote per te gjithë elementet e mesiperme ,

krjuam siguri te arsyeshme se klasifikimi dhe paraqitja ne pasqyrat financiare eshte i sakte ne perputhje me

vleresimin , destinacionin e perdorimit dhe dokumentacioni ligjor justifikues. Per shpenzimet ne verifikuam te gjitha dokumentat ligjor justifikues.

7. Teprice mjete monetare ne 31.12.2017

- Gjendje ne 01.01.2017	941,818 leke.
- Te hyra (buxheti i shtetit)	(+) 4,833,333 leke
- Pagesa shpenzime	(-) 3,431,023 leke
- . Teprice mjete monetare ne 31.12.2017.....	2,344,128 leke.

8. Gjendja e debi – kredive .

Nga verifikimi teresor ne kontaktet e listes se klienteve dhe furnitoreve te subjektit politik rezulton se per gjendjen ne 31.12.2017 nuk ka kliente dhe furnitore te palikujduar.

9. Efekti i ngjarjeve ekonomike pas bilancit.

Nga zbatimin e procedurave audit rezulton se nuk ka ngjarje te mevoneshme me impakt ndikimi ne pasqyrat financiare te vitit 2017.

Audituesi Ligjor(EKR)

Gezim JAUPAJ

Auditing
"JAUPAJ-G"
SH.P.K.
Tirane - Albania

Tirane, me 06.07.2018

DEKLARATE

Dofhur me auditimin ligjor te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga "Partia Demokratike e Shqiperise", me adrese RR Abdi Toptani Ish Hotel Dreni, Tirane

per vitin kalendarik 2017 deklaroi te dhena si me poshte:

-Fondet e perfituara per vitin 2017 jane 4,888,339 leke

-Fondet e shpenzuara per vitin 2017 jane 3,430,969 leke

-Përfadësuesi i partise politike per te siguruar dokumentacionin per auditimin eshte Ariona Hoxha

-Personi pergjegjes per kontabilitetin eshte Ariona Hoxha

-Personi pergjegjes per pranimin e donacioneve eshte Ariona Hoxha

-Llogarite bankare qe ka partia eshte vetem nje prane Tiana Bank ne leke

Burimet e financimit

Nr	Burimet e financimit	Shuma leke
1.	Kuptat e anetaresise	
2.	Fondet publike	4,888,339
3.	Dhurimet	
4.	Sherbimet	
5.	Sponsorizimet	
6.	Dhurime ne natyre	
7.	Te tjera	

Deklarues

Ariona Hoxha

Personi i Autorizuar

